



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 671, datë 08.11.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT ARDIT MUSTAJ, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Ardit Mustafaj, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit Ardit Mustafaj, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar (shih dokumentet 1, 2, 3 dhe dosjet 1 e 2), si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal. Në 3 dokumentet e përzgjedhur prej tij dhe 2 nga 5 dosjet gjyqësore konfirmohen njohuritë e gjera të tij, bie në sy e drejta penale (shih dokumentet 1,2 e 3 dhe dosjet 1e 2), masat e sigurimit në procesin penal (shih dosjen 3) dhe e drejta procedurale penale në shqyrtimin e kërkesave adm-penale (shih dosjet 4 e 5). Në përgjithësi, në vendimet gjyqësore të tij nuk shënohen shprehimisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, por në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit, ai përdor referenca nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë (shih dokumentin 1 dhe dosjet 1 e 5) dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentin 2). Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se vetëm në një rast subjekti i rivlerësimit ka disponuar me deklaram të pafajësisë për njërin nga të pandehurit (shih dosjen 5) dhe në një rast tjetër me rrëzimin e kërkesës së kërkuarit (shih dosjen 5). Nga ana tjetër, prej 5 dosjeve të vëzhguara, palët ndërgjyqëse kanë paraqitur ankim kundër vendimit të dhënë prej tij në tre raste (shih dosjet 1, 2 e 5). Në dy nga tre rastet, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të shkallës së parë të dhëna nga gjyqtari Ardit Mustafaj, ndërsa për rastin e tretë e ka ndryshuar vendimin vetëm sa i përket masës së dënimit, duke e zbutur atë. Për dy dosjet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët. Po kështu, edhe për tre dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, rezulton se është ushtruar ankim nga palët, por 3 vendimet e gjyqtarit janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit për krime të rënda”.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, referuar natyrës së gjykimit (gjykim penal themeli apo kërkesë penale) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), rrethanat e faktit parashtrihen në pjesën e parë apo të dytë të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimit. Rrethanat e faktit, në vendimet të analizuara, paraqiten më vete dhe në disa raste të ndërthurura me pretendimet e palëve apo dhe me provat që kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit. Gjyqtari, në fillim të pjesës përshkuese arsyetuese të vendimit, ndalet në elementë të ecurisë procedurale të çështjes (kërkesa për gjykim të shkurtuar, kompetenca në disa raste, zhvillimi i gjykimit në mungesë të të pandehurit etj), duke vijuar me përshkrimin e faktit penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara.

Paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit në çdo rast është e detajuar, e qartë dhe e plotë duke përshkruar ngjarjen gjatë së cilës ka ndodhur fakti penal/faktet penale, rolin e të pandehurit/ve në realizimin e tij, veprimet që tregojnë bashkëpunimin midis të pandehurve etj.

Pas paraqitjes dhe analizës së faktit penal në pjesën e parë apo të dytë të arsyetimit të vendimit, si në çështjet në të cilat është proceduar me gjykim të shkurtuar ashtu edhe në ato në të cilat është proceduar me gjykim të zakonshëm, gjyqtari bën paraqitjen e provave duke evidentuar, në

një pjesë të tyre, elementët e faktit që rezultojnë të mbështetur në secilën provë. Paraqitja e rrethanave të faktit dhe paraqitja e provave mbi të cilat mbështetet, në disa raste bëhet duke cituar në mënyrë eksplicite përmbajtjen e provës përkatëse (*në rastin e dëshmimeve, bisedave telefonike të transkriptuara etj.*) në shërbim të vërtetimit të ekzistencës së faktit penal dhe rolit të të pandehurve, i jep qartësi faktit penal dhe mbështetet provueshmërinë e fakteve objekt gjykimi. Gjithashtu, paraqitja dhe analiza e rrethanave të faktit, kur është e nevojshme, përqendrohet edhe në evidentimin e elementëve apo veprimeve që provojnë ekzistencën e rrethanave të tilla si, formën e kryerjes së veprës penale, elementët e bashkëpunimit ose mungesën e tyre, mbetjen e veprave penale në fazën e tentativës, lidhjen shkakësore, autorësinë, analizën e elementëve cilësues të veprave penale për të cilat procedohet, etj.

Provat dhe faktet e paraqitura nga mbrojtja e të pandehurit/të paditurit, evidentohen në mënyrë të hollësishme në përmbajtjen e arsyetimit të vendimit, si dhe në pjesën që i kushtohet individualizimit të dënimit në rastet kur provat dhe faktet kanë lidhje me këtë aspekt.

Në tërësi, evidentohet se gjyqtari, përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, të cilat pavarësisht se nuk rezultojnë si një nën pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe i integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht.

-Identifikimi i natyrës së çështjes

Në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, duke i dhënë rëndësinë e duhur, ku edhe pse jo gjithmonë duke e shprehur në mënyrë eksplicite, por del qartë në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi, referuar identifikimit të elementëve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridik në çështje me natyra të ndryshme (*penale themeli apo të kërkesave penale gjatë fazës së hetimit paraprak*).

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- Konkretisht, gjyqtari identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal nenin 283/a të K.Penal në lidhje me veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”;¹ nenin 333/a dhe 334 të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale të “Grupit të strukturuar kriminal” dhe “Kryerjes së veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, nenin 298/3 i Kodit Penal, për veprën penale të “Ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufijve”, nenin 189/2 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale të “Falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave” si dhe

¹Vendimet nr.59, datë 08.05.2015, nr.85, datë 11.07.2014, nr. 76, datë 15.06.2015, nr. 38, datë 20.03.2014, nr.6, datë 15.01.2014, nr.149, datë 26.12.2014, nr. 61, datë 11.05.2015.

nenin 188/1 të Kodit Penal në lidhje me veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve shëndetësore” ;² nenin 109/b/1 e 25 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” të kryer në bashkëpunim;³ nenet 79/c, 22, 278/3 dhe 278/2 të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale të “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare”, mbetur në tentativë, “Mbajtjes pa leje të armëve”, “Mbajtjes pa leje të municioneve luftarake”.⁴

- Në çdo rast, referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. në lidhje me moshën për përgjegjësi penale (neni 12 i K.Penal), kuptimin e tentativës dhe përgjegjësinë penale për veprat e mbetura në këtë fazë (nenet 22 dhe 23 të K.Penal), në lidhje me institutin e bashkëpunimit (nenet 25 dhe 26 të K.Penal) dhe format e veçanta të bashkëpunimit (neni 28 i K.Penal), kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (neni 47 i K. Penal), rrethanat lehtësuese dhe rënduese (nenet 48, 49 dhe 50 të K. Penal), etj.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit apo themeli*) apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*) gjyqtari identifikon dispozitat procedurale si më poshtë:

- nenin 140 të K.Pr.Penale në lidhje me njoftimin e të pandehurit të lirë, nenin 141 të K.Pr.Penale në lidhje me kërkimin e të pandehurit si dhe nenet 351 dhe 352 të K.Pr.Penale në lidhje me në lidhje me deklarimin e mungesës së të pandehurit në gjykim, nenet 373 dhe 376/3 të K.Pr.Penale në lidhje me komunikimin e akuzës së pandehurit të mosgjetur, në lidhje me mundësinë e ushtrimit të të drejtave të të pandehurit të deklaruar në mungesë;
- nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar; nenet 151 dhe 152 në lidhje me çmuarjen e provave dhe vlerën e tyre provuese;
- nenin 370 të K.Pr.Penale, në lidhje me kundërshtimin e deklarimeve të të pandehurit; nenet 152, 166 dhe 370/1 të K.Pr.Penale në lidhje me vërtetësinë e deklarimeve të të pandehurit, të cilat bien në kundërshtim me provat e marra në gjykim;
- nenet 228, 230, 251, 258, 244, 259 në lidhje me vlerësimin sa i përket ligjshmërisë së arrestimit në flagrancë, konceptin e “dyshimit të arsyeshëm”, kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masave të sigurimit personal dhe përshtatshmërinë e tyre;
- nenet 294/a, 294/b dhe 222 të K.Pr.Penale, në funksion të zbulimit të aktivitetit kriminal nga ana e të pandehurve, nëpërmjet kryerjes së veprimeve stimuluese si dhe nenin 222/1 paragrafi i dytë i K.Pr.Penale, në lidhje me përgjimin në vende publike të të pandehurve;
- nenin 166 të K.Pr.Penale mbi pyetjen e të pandehurit; nenet 362, 369 të K.Pr.Penale në lidhje me kundërshtimin e dëshmisë së dhënë dhe leximet e lejueshme; nenet 393 të K.Pr.Penale lidhur me shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore në procesin penal;
- nenet 8 dhe 98 të K.Pr.Penale në lidhje me gjuhën e akteve procedurale penale në rastet e personave që nuk flasin gjuhën shqipe, si dhe pasojën e pavlefshmërisë të tyre në rast të shkeljes së këtyre rregullave.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

² Vendimi nr. 44, datë 05.04.2016

³ Vendimi nr. 95, datë 11.07.2016 dhe vendimi nr. 102, datë 27.11.2013

⁴ Vendimi nr. 87.24.06.2016

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin e “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit Ardit Mustafaj ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar (shih dokumentet 1, 2, 3 dhe dosjet 1 e 2), si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal. Në 3 dokumentet e përzgjedhur prej tij dhe 2 nga 5 dosjet gjyqësore konfirmohen njohuritë e gjera të tij, bie në sy e drejta penale (shih dokumentet 1,2 e 3 dhe dosjet 1e 2), masat e sigurimit në procesin penal (shih dosjen 3) dhe e drejta procedurale penale në shqyrtimin e kërkesave adm-penale (shih dosjet 4 e 5...)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet përfundimtare të gjyqtarit identifikohet, citohet dhe analizohet norma ligjore konkrete në shërbim të analizës së fakteve dhe konkluzioneve të arritura lidhur me zbatimin e normës. Identifikimi i normës juridike procedurale dhe materiale, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari në lidhje me zbatimin e saj. Interpretimit të normës i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, duke i kushtuar rëndësi jo vetëm interpretimit të normës materiale por dhe asaj procedurale në rastin e kërkesës penale për vleftësim arresti dhe caktimi i masës së sigurimit⁵, në rastin e kërkesës për deklarimin e ikjes së personit nën hetim⁶ apo në rastin e kërkesës për revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit arrest në burg⁷.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, evidentohet identifikimi dhe interpretimi i normës juridike si procedurale ashtu dhe materiale, si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, në pjesën në të cilën pasqyrohet vlerësimi i gjykatës, duke pasqyruar analizë ligjore të plotë si dhe duke e integruar atë me analizën në lidhje me aplikimin mbi faktet e çështjes konkrete.

- Në drejtim të interpretimit të dispozitave procedurale :

Gjyqtari ka referuar dhe interpretuar në mënyrë të hollësishme dhe të shkurtuar, sipas rastit, dispozita të veçanta të ligjit procedural, kryesisht në lidhje me:

- Gjykimin e shkurtuar, ku në çdo rast referohet neni 404 i K.Pr.Penale dhe jepet kuptimi i tij, si dhe kushtet për pranimin ose jo të kërkesës për procedim me këtë lloj gjykimi, duke referuar në mbështetje të interpretimit të ligjit procedural edhe qëndrimin e Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr.2, datë 29.01.2003, në rast kur kërkesa e të pandehurit nuk është pranuar për shkak se gjykata ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet;⁸
- Çmuarjen e provave në tërësinë e tyre sipas nenit 152/1 të K.Pr.Penale, në lidhje me përcaktimin e vërtetësisë dhe fuqinë provuese të tyre dhe në lidhje me vlerën e provave të cilat nuk kanë vlerë të paracaktuar por i nënshtrohen shqyrtimit dhe çmuarjes së tyre në tërësi;⁹
- respektimin e të drejtave dhe garancive procedurale për të pandehurin në mungesë për të patur mbrojtës duke i caktuar mbrojtës; deklaratimet e të pandehurit gjatë gjykimit dhe vlerën provuese të tyre, deklaratimet e dëshmitarëve në kuadër të kundërshtimit të dëshmisë dhe vlerën provuese të tyre, etj.¹⁰
- paraqitjen e akuzës së re gjatë gjykimit si dhe kushtet e pranimin të këtyre kërkimeve si dhe procedimin në lidhje me njoftimin e të pandehurit lidhur me këto zhvillime procedurale.¹¹

Në vendimet e tjera burim vlerësimi, dispozitat procedurale penale citohen dhe zbatohen drejtpërdrejtë në mbështetje të vendimmarrjes së gjykatës në raport me zbatimin e tyre apo në mbështetje të rrethanave specifike procedurale në të cilat ato gjejnë zbatim.

⁵ Vendimi nr. 253 akti, datë 15.05.2014

⁶ Vendimi nr. 246 akti, datë 26.07.2016

⁷ Vendimi nr. 61, datë 21.03.2016

⁸ Vendimet nr. 44, datë 05/04/2016, nr. 102, datë 27.11.2013, nr. 61, datë 11.05.2015, nr. 59, datë 08.05.2015, nr. 85, datë 11.07.2014, nr. 38, datë 20.03.2014 dhe nr. 6, datë 15.01.2014

⁹ Vendimi nr. 76, datë 15.06.2015

¹⁰ Vendimet nr. 87, datë 24.06.2016 dhe nr.95, datë 11.07.2016

¹¹ Vendimi nr.87, datë 24.06.2016

- Në drejtim të interpretimit të ligjit material të zbatueshëm:

Sa i përket interpretimit të ligjit material të zbatueshëm, në pjesën me të madhe të vendimeve burim vlerësimi citohen dhe interpretohen dispozitat të Kodit Penal të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të cilat janë vlerësuar me vend për t'u marrë në analizë në mbështetje të arsytimit të vendimit.

Kryesisht dispozitat e pjesës së përgjithshme të ligjit penal material interpretohen në mënyrë të integruar me faktet e provuara në gjykim, në lidhje me bashkëpunimin e thjeshtë,¹² format e veçanta të bashkëpunimit,¹³ tentativën dhe përgjegjësinë penale për veprat penale të mbetura në këtë fazë,¹⁴ dashjen si formë e fajësisë, format e veçanta të kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”, mënyrën e caktimit të dënimit, rrethanat rënduese dhe lehtësueses që ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, mos plotësimin e kushteve të veçanta ligjore për uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar në ligj,¹⁵ mos plotësimin e kërkesave ligjore për aplikimin e pezullimit të vendimit me burgim.¹⁶

Dispozitat e ligjit penal material janë interpretuar në çdo rast në shërbim të konkluzioneve të gjykatës lidhur me elementet të ndryshëm të faktit penal, elemente të ekzistencës së veprës penale, përgjegjësinë penale të pandehurve në raport me veprat për të cilat procedohet, caktimin e llojit dhe masës së dënimit për secilin të pandehur në raport me kushtet dhe rrethanat specifike të tij, etj.

Në tërësi interpretimi ligjor i dispozitave të ligjit material është kryer në mënyrë të veçantë dhe në aspektin teorik, duke e integruar gjithashtu dhe me rrethanat e faktit të provuar në gjykim apo pretendimeve të palëve në lidhje me zbatimin e dispozitave të veçanta të ligjit procedural dhe material.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht:

- vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar;
- vendimin unifikues nr. 4, datë 15.04.2011, në lidhje me orientimet për kryerjen e veprave penale në bashkëpunim;¹⁷
- vendimin unifikues nr. 1, datë 25.03.2005, në lidhje me kryerjen e veprës penale me dashje

¹²Vendimi nr.95, datë 11.07.2016, nr. 85, datë 11.07.2014, nr.149, datë 26.12.2014, nr. 76, datë 15.06.2015

¹³Vendimi nr.44, datë 05.04.2016

¹⁴Vendimi nr.149, datë 26.12.2014, nr.61, datë 11.05.2015, nr. 59, datë 08.05.2015, nr. 38, datë 20.03.2014, nr. 6, datë 15.01.20014

¹⁵Vendimet nr.38, datë 20.03.2014

¹⁶Vendimi nr.59, datë 08.05.2015

¹⁷ Vendim nr. 95, datë 11.07.2016

direkte me qëllim përfitimin pasuror pa të drejtë për vete dhe që kanë dijeni për paligjshmërinë e përfitimit pasuror;¹⁸

- vendimin unifikues e Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 15.04.2011, në lidhje me institutin e bashkëpunimit.¹⁹
- vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me shfuqizimin e dënimeve me gjobë të parashikuara në dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal si dënime kryesore bashkërisht me dënimin me burgim;²⁰

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Vlen të theksohet fakti se gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes gjyqtari zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet përgjithësisht të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Evidentohet se gjyqtari njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë: parimi i prezumimit të pafajësisë, parimi i ligjshmërisë, fuqia e plotë provuese e akteve shkresore, evidentohet gjithashtu, përmbushja e parimit të kontradiktoritetit e barazisë së palëve si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu njeh dhe zbaton parimet e së drejtës materiale të cilat i shërbejnë dhe i vijnë në ndihmë interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në themel si parimi i humanizmit (*parim i zbatuar në vendimet penale në lidhje me individualizimin e dënimit për të pandehurin*).

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;

¹⁸ Po aty

¹⁹ Vendimi nr. 149, datë 26.12.2014

²⁰ Vendim nr. 102, datë 27.11.2013

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit Ardit Mustafaj ka aftësi në arsyetimin ligjor, Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtëshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor gjithmonë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe..*”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtari, përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdoruara nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine, por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD -së lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*..Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban të gjithë elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural penal. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve ”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit, të cilat edhe pse nuk ndahen në mënyrë të qartë me nënndarje të përcaktuara me tituj, në çdo vendim, del qartë pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese si dhe dispozitivi i tij.

Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë ose objektin e kërkesës dhe nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese- arsyetuese e vendimeve gjithashtu ndjek një strukturë të mirë përcaktuar, e cila ndiqet në çdo rast, të organizuar me paragrafë me qëllim orientimin e lexuesit. Organizimi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli apo kërkesë penale*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), rrethanat e faktit parashtrohen në pjesën e parë apo të dytë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, duke u përshkruar fakti penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. E gjithë përmbajtja e vendimit është e ndarë në paragrafë të cilat edhe pse nuk përmbajten numërtim ose gërmëzim, lidhen me njëri tjetrin duke krijuar vijueshmëri të arsyetimit.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, disponimin e plotë për provat materiale, shpenzimet procedurale si dhe të drejtën e ankimit.

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor sipas pjesëve të vendimit, zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Në të gjitha vendimet e analizuar, është ndjekur një strukturë e njëjtë, duke i bërë ato lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme për lexuesin në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim*);

Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Subjekti i rivlerësimit Ardit Mustafaj ka aftësi në arsyetim ligjor... Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimeve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kuptueshme. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.... Ai gjithmonë i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat asnjëherë nuk mungon arsyetimi, pasi ka proceduar duke nxjerrë vendime të ndërmjetme dhe duke treguar shkakun ligjor (shih dosjet 1, 2, 3, 4 dhe 5)”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale.

Në secilin vendim, duku iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit penal, apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm apo i shkurtuar*), argumentet e gjykatës shtjellohen në mënyrë logjike, dhe e detajuar e fakteve esenciale të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim, të cilat merren në analizë në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj. Gjyqtari, evidenton në mënyrë të qartë lidhjen shkak pasojë mes veprimeve të të pandehurve në raport me faktin penal të provuar.

Dispozitat e ligjit procedural penal referohen dhe analizohen në mbështetje të vlerësimit të gjyqtarit në raport me zbatimin e tyre si dhe dispozitat normave ligjore materiale e procedurale, analizohen në raport me faktet e provuara në gjykim, në shërbim të provueshmërisë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet.

Në analizën e faktit penal, gjyqtari bën një analizë të integruar të provave në raport me secilin fakt të evidentuar, si të rëndësishëm në lidhje me elementët e veprës penale dhe rolin e secilit të pandehur në raport me veprat penale për të cilat procedohet. Në lidhje me cilësinë e analizës së dispozitave ligjore dhe aplikimin e tyre mbi faktet konkrete të çështjes, në të gjitha vendimet, identifikohet referimin i dispozitave të ligjit duke u shoqëruar me analizë ligjore të veçantë të kuptimit të tyre.

Në pjesën e vlerësimit të gjykatës, ku merret në shqyrtim ekzistenca dhe provueshmëria e faktit penal, kualifikimi ligjor i tij dhe fajësia e të pandehurve si dhe roli i tyre në raport me faktin, analiza dhe arsyetimi përqendrohet në faktin penal të provuar në gjykim, duke u ndalur gjithashtu dhe në analizën e dispozitave ligjore në raport me faktin penal.

Në lidhje me pretendimet e palëve në gjykim, ato merren në shqyrtim dhe analizohen jo në një pjesë të veçantë të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke i dhënë gjithnjë përgjigje të argumentuar dhe duke i analizuar ato në aspektin e mbështetjes në ligj ose në prova.

KONKLUZIONI

Në tërësi, arsyetimi i vendimeve përfundimtare të vazhduara, ndjek një zhvillim logjik, duke i kushtuar rëndësinë e duhur parashtrimin të faktit penal, provave dhe analizës së tyre në raport me veprat penale dhe rolin e të pandehurve në kryerjen e tyre, si dhe një analizë e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në çdo rast konkret, në funksion dhe në mbështetje të konkluzioneve të gjykatës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Nivelin e vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin Ardit Mustafaj, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short gjer në

dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme, kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 24 orë e 53 minuta (shih dosjen 3), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 1 muaj e 10 ditë (shih dosjen 1). Në 3 rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 1 muaj (shih dosjen 2) dhe 4 ditë (shih dosjet 4 e 5). Nga analiza e këtyre të dhënave, në raport me standardin kohor 12 mujor për çështjet penale të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, sipas pikës 5 shkronja “f” të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se 2 çështjet penale të themelit, por edhe 2 kërkesat adm-penale janë përfunduar brenda afateve standard 2 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “j” të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit. Po kështu vleftësimi i arrestit e caktimi i masës së sigurimit personal është përfunduar nga gjyqtari brenda afatit procedural penal të 48 orëve”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Ndërkohë për shqyrtimin e kërkesave të fazës së hetimeve paraprake dhe kërkesave për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë në bazë të ligjit të posaçëm, parashikohen afate ligjore gjykimi.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për 2 prej tyre (dosja 3 dhe dosja 5) ligji procedural ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi. Konkretisht;

Dosja 3 me objekt “Vleftësimi i arrestit dhe caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 228 e vijues të K.Pr.Penale. Neni 259/5 i Kodit të Procedurës Penale (sipas formulimit të dispozitës në kohën e zhvillimit të gjykimit) parashikon shqyrtimin e kërkesës brenda afatit 48 orë nga momenti i paraqitjes së kërkesës së prokurorisë në gjykatë. Në rastin konkret, gjykimi i çështjes ka zgjatur 24 orë e 53 minuta, në intervalin kohor 14.05.2014 ora 15.00-15.05.2014 ora 15.07, duke respektuar afatin ligjor 48 orësh nga momenti i regjistrimit të saj sipas nenit 259 pika 5 të K.Pr.P²¹.

Dosja 5 me objekt “Revokim ose zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga nenet 228 e vijues dhe 246/6 e 260 të K.Pr.Penale. Neni 260/4 i i Kodit të Procedurës Penale (sipas formulimit të dispozitës në kohën e zhvillimit të gjykimit) parashikon shqyrtimin e kërkesës brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Në rastin konkret, gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 4 ditë, në intervalin kohor 17.03.2016-21.03.2016, duke respektuar afatin ligjor 5 ditor sipas parashikimeve të nenit 260/4 të K.Pr.Penale²².

²¹ Në nenin 259 pika 5 të K.Pr.Penale parashikohet se :”5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë.”

²² Në nenin 260 pika 4 të K.Pr.Penale parashikohet se :”Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokim ose zëvendësimin e masës shqyrtohet nga gjykata brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Kur është rasti gjykata vendos edhe kryesisht gjatë procedimit për sigurimin e provës ose gjatë gjykimit.”

Për sa më sipër, duke iu referuar çështjeve për të cilën ligji parashikon afate ligjore shqyrtimi, rezulton se këto afate janë respektuar. Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat afati ligjor i gjyqimit është respektuar, aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjyqimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara, për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se nga ana e gjyqtarit janë respektuar standardet minimale kohore të gjyqimit, duke iu referuar të njëjtit konkluzion të cituar në treguesin më sipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjyqimit për çështjet me afati ligjor dhe standard minimal kohor është bërë së bashku në raport.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 9 nga çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi dhe 3 nga vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së. Konkretisht;

- (i) Dokumenti 1, që i përket vendimit nr. 85, datë 11.07.2014, dosja penale është regjistruar në datë 30.09.2013 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 11.07.2014, pra për 9 muaj e

- 11 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (ii) Dokumenti 2, që i përket vendimit nr. 76, datë 15.06.2015, dosja penale është regjistruar në datë 27.06.2014 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 15.06.2015, pra për 11 muaj e 18 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (iii) Dokumenti 3, që i përket vendimit nr. 44, datë 05.04.2016, dosja penale është regjistruar në datë 30.10.2015 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 05.04.2016, pra për 5 muaj e 5 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (iv) Dosja 1, që i përket vendimit nr. 102, datë 27.11.2013, është regjistruar në datë 16.10.2023 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 27.11.2013, pra për 1 muaj e 11 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (v) Dosja 2, që i përket vendimit nr. 59, datë 08.05.2015, është regjistruar në datë 02.04.2015 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 08.05.2015, pra për 1 muaj e 6 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (vi) Dosja 4, që i përket vendimit nr. 246, datë 26.07.2016, është regjistruar në datë 22.07.2016 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 26.07.2016, pra për 4 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 2 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (vii) Dosja 6, që i përket vendimit nr. 38, datë 20.03.2014, është regjistruar në datë 28.01.2014 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 20.03.2014, pra për 1 muaj e 21 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (viii) Dosja 7, që i përket vendimit nr. 6, datë 15.01.2014, është regjistruar në datë 19.11.2013 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 15.01.2014, pra për 1 muaj e 28 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (ix) Dosja 8, që i përket vendimit nr. 149, datë 26.12.2014, është regjistruar në datë 24.03.2014 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 26.12.2014, pra për 9 muaj, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (x) Dosja 9, që i përket vendimit nr. 61, datë 11.05.2015, është regjistruar në datë 18.03.2015 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 11.05.2015, pra për 2 muaj e 7 ditë, ***brenda afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (xi) Dosja 10, që i përket vendimit nr. 95, datë 11.07.2016, është regjistruar në datë 29.07.2015 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 11.07.2016, pra për 12 muaj e 18 ditë ***jasthtë afatit standard minimal kohor*** prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- (xii) Dosja 11, që i përket vendimit nr. 87, datë 24.06.2016, është regjistruar në datë 29.12.2015 dhe gjykimi ka përfunduar në datë 24.06.2016, pra për 5 muaj e 26 ditë,

brenda afatit standard minimal kohor prej 12 muajve të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor nuk është respektuar vetëm në një çështje (dosja 10) dhe ky tejkalim është vetëm 18 ditë, duke u konsideruar një tejkalim i papërfillshëm i këtij afati. Pra, rezulton se gjyqtari ka respektuar standardin minimal kohor në fuqi për të gjitha çështjet e analizuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 0 %.*

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të Inspektoratit të KLD-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e posaçme (Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në periudhën e vlerësimit).

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 9 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit²³. Duke krahasuar kohën mesatare që i

²³ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” *Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.*”

dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për kategori (*çështjet e marra në analizë janë çështje penale krime dhe një çështje i përket kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak*), për 9 çështjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 11 çështjet e kategorisë së çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 151 ditë ose rreth 5 muaj, ndërsa për 1 çështje të kategorisë “kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” kohëzgjatja e gjykimit është 4 ditë.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.*

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD -së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti rivlerësimit Ardit Mustafaj në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në dhomën penale. Ai ka deklaruar se për periudhën 2014-2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 438 çështje, ka përfunduar si relator 423 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 4 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 96.5 %*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Subjekti rivlerësimit Ardit Mustafaj në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Lidhur me ngarkesën sasiore, ai ka deklaruar se për periudhën 2014-2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 438 çështje, ka përfunduar si relator 423 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 4 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 96.5 %”.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 96.5% i përcaktuar në faqen 21 të Raportit, faqe 652 e dosjes së rivlerësimit.

Gjyqtari Ardit Mustafaj ka paraqitur kundërshtimet në lidhje me këtë tregues duke parashtruar se : “Nga Projektraporti rezulton se treguesi 2.A.Ç. “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është vlerësuar me 8 pikë, nga 10 të mundshme. Projektraporti shprehet se në periudhën 2013-2016 gjyqtarit i janë caktuar për gjykim gjithsej 438 çështje, ka përfunduar si relator 423 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 4 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 96.5 %, prandaj ky tregues pikëzohet me 8 pikë.Lidhur me këtë tregues, sqarohet se:a) Mbartja e 4 çështjeve ka ardhur për shkaqe tërësisht objektive. Gjykimi i tyre brenda vitit 2016 ka qenë objektivisht i pamundur, siç do të shpjegohet më poshtë:

Çështja penale nr.7/37/199 regj.them., datë 12.12.2016 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Denis Shtraza, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit”, paraprirë ose shoqëruar me tortura fizike dhe kur është shkaktuar vdekja e tij, e kryer në bashkëpunim, dhe “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të parashikuara respektivisht nga nenet 109/3 e 25, 278/1 të K.Penal, e cila është përfunduar me vendimin nr.31, datë 19.03.2018, ku i pandehuri është deklaruar fajtor për veprat penale për të cilat akuzohej dhe është dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë në fund të vitit, më datë 12.12.2016, dhe ishte objektivisht e pamundur të përfundohej deri më datë 31.12.2016 (për 19 ditë), për më tepër duke pasur parasysh natyrën e veprave penale objekt gjykimi dhe kompleksitetin e çështjes. Krahas kësaj, sipas nenit 333 të K.Pr.Penale²⁴, gjyqtari ka 10 ditë kohë për të caktuar seancën e parë gjyqësore dhe njoftimin për këtë seancë palët duhet ta marrin jo më pak se 10 ditë para. Respektimi i këtyre afateve ligjore ka sjellë që çështja detyrimisht të mbartej për vitin 2017 (madje as seanca e parë gjyqësore objektivisht nuk mund të caktohej brenda vitit 2016).

Çështja penale nr.8/42/204 regj.them., datë 16.12.2016 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Lekë Ballza, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare”, mbetur në tentativë, dy herë, dhe “Mbajtjes pa leje të armëve në banesë”, të parashikuara nga nenet 79/c e 22 (dy herë), 278/3 të K.Penal, e cila është përfunduar me vendimin nr.21, datë 22.02.2018, ku i pandehuri është deklaruar fajtor për veprat penale për të cilat akuzohej dhe është dënuar përfundimisht me 16 vjet burgim. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë në fund të vitit, më datë 16.12.2016, dhe ishte objektivisht e pamundur të përfundohej deri më datë 31.12.2016 (për 15 ditë), për më tepër duke pasur parasysh natyrën e veprave penale objekt gjykimi dhe kompleksitetin e çështjes. Krahas kësaj, respektimi i afateve të parashikuara nga neni 333 të K.Pr.Penale ka sjellë detyrimisht që çështja të mbartej për vitin 2017 (e njëjta situatë sikurse në çështjen ndaj të pandehurit Denis Shtraza më lart).

²⁴ Neni 333 i K.Pr.Penale, parashikon:

“Caktimi i seancës

1. Brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit ose të viktimës akuzuese, kryetari i trupit gjykues, i ngarkuar për gjykimin e çështjes cakton datën e seancës gjyqësore.
2. Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, viktimës, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre të paktën dhjetë ditë para datës së caktuar për gjykim.”

Çështja penale nr. 6/27/180 regj.them., datë 27.10.2016 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit Orvel Hebeja, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve” në bashkëpunim, mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 e 22 të K.Penal, e cila është përfunduar me vendimin nr.1, datë 09.01.2018, ku i pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën akuzohej dhe është dënuar përfundimisht me 8 vjet e 8 muaj burgim. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë më datë 27.10.2016, pra afër fundit të vitit, dhe ishte objektivisht e pamundur të përfundohej deri më datë 31.12.2016 (për 2 muaj e 4 ditë), për më tepër duke pasur parasysh natyrën e veprës penale objekt gjykimi dhe kompleksitetin e çështjes. Krahas kësaj, respektimi i afateve të parashikuara nga neni 333 të K.Pr.Penale, detyrimisht ka passjellë që seanca e parë gjyqësore të caktohej jo më parë fundi i muajit Nëntor. Kjo çështje ka pasur edhe një specifikë tjetër që ka shkaktuar zgjatjen e gjykimit për shkaqe të pavarura nga gjykata. I pandehuri Orvel Hebeja ishte me banin në Fier dhe me masë sigurimi “arrest në shtëpi” dhe në shumicën e seancave nuk shoqërohej në gjykatë nga policia, pa shkaqe të arsyeshme. Kjo situatë e pazakontë dhe masat e marra nga gjykata janë përmendur edhe në faqen 2 të vendimit përfundimtar të gjykatës, në të cilin thuhet: “... Duhet përmendur paraprakisht se i pandehuri, në shumë prej seancave gjyqësore, nuk është shoqëruar në gjykatë nga organi i policisë vendore Fier (meqenëse ai është më masë sigurimi “arrest në shtëpi” të caktuar gjatë fazës së hetimit paraprak) dhe gjykata për të mundësuar zbatimin e urdhrave të saj për shoqërimin e të pandehurit në gjykatë, me qëllim zhvillimin e procesit gjyqësor brenda afateve të arsyeshme, është detyruar disa herë që të informojë edhe institucionet qendrore shtetërore përkatëse (Ministrinë e Punëve të Brendshme, etj.). ...”.

Çështja penale nr. 32/191 regj.them., datë 17.11.2016 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurve Bledar Buci, Flori Broca dhe Kevin Kola, të akuzuar për veprën penale të “Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109/b/1 dhe 25 të K.Penal, e cila është përfunduar me vendimin nr.44, datë 23.05.2017, ku të pandehurit janë deklaruar fajtor për veprat penale për të cilat akuzoheshin dhe dënuar. Kjo çështje është regjistruar në gjykatë më datë 17.11.2016, pra afër fundit të vitit, dhe ishte objektivisht e pamundur të përfundohej deri më datë 31.12.2016 (për 1 muaj e 13 ditë), për më tepër duke pasur parasysh numrin e të pandehurve, natyrën e veprës penale objekt gjykimi dhe kompleksitetin e çështjes. Krahas kësaj, respektimi i afateve të parashikuara nga neni 333 të K.Pr.Penale, detyrimisht ka passjellë që seanca e parë gjyqësore të caktohej jo më parë se në Dhjetor 2016 dhe gjykata ka bërë të gjitha përpjekjet që ta përfundojë brenda vitit, duke caktuar 3 seanca gjyqësore gjatë muajit dhjetor 2016 (megjithë ngarkesën e gjykatës me gjykime të tjera), të cilat janë shtyrë për shkaqe objektive, konkretisht: seanca e parë datë 06.12.2016 është shtyrë për shkak të mosnjoftimit të të pandehurit Kevin Kola nga policia gjyqësore; seanca vijuese datë 19.12.2016 është shtyrë pasi mungonte për shkaqe të arsyeshme i pandehuri Flori Broca; seanca vijuese datë 27.12.2016 është shtyrë për datë 11.01.2017 me kërkesë të prokurorit, për t'i dhënë kohë për diskutimin përfundimtar.

Lidhur me faktet e mësipërme, bashkëngjitur ju paraqes si prova: vendim penal nr.31, datë 19.03.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë (30 faqe); vendim penal nr.21, datë 22.02.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë (19 faqe); vendim penal nr.1, datë 09.01.2018, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë (19 faqe); vendim penal nr.44, datë 23.05.2017, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, së bashku me procesverbalin gjyqësor të seancave datë 06.12.2016, 19.12.2016 dhe 27.12.2016 (17 faqe + 10 fletë). Sqarohet se paraqitja e këtyre vendimeve nuk vjen në

kundërshtim me nenin 94, pika 2, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi bëhet vetëm për të vertetuar faktet e mësipërme.

b) Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kur rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore është në kufijtë 93-99% ky tregues pikëzohet 8 pikë, ndërsa kur është mbi 99% pikëzohet 10 pikë. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga ana ime për vitet 2013-2016 ka rezultuar 96.5%, i cili është afër kufirit prej 99%. Për këto arsye, si përfundim, duke pasur parasysh shkaqet tërësisht objektive të mbartjes së katër çështjeve penale të cituara më lart dhe rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore nga ana ime që është afër kufirit 99%, ju parashtoj këtë kërkesë që vlerësimi lidhur me treguesin 2.A.Ç. “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, të jetë maksimal, 9 ose 10 pikë.”

Bazuar në sa më sipër, Këshilli duke marrë parasysh dhe kundërshtimet e paraqitura nga ana e gjyqtarit, të diskutuara në mbledhjen plenare, u arrit në përfundimin që gjyqtari të vlerësohet me pikëzim maksimal.

KONKLUZIONI

Rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit duhet konsideruar në masën +99% duke pikëzuar me 10 pikë për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 10 pikë, pasi ky rendiment është në masën +99%.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

- Informacioni i përcjellë nga gjykata²⁵ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLGJ-së, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: “...Si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore ne sekretari, si e dhëna e vetme objektive në lidhje me këtë fakt. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtari Ardit Mustafaj i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit në kohë të vendimeve. Konkretisht arsyetimi i vendimeve është kryer për 1 ditë nga shpallja (shih dosjet 3 e 4), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 5), për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen 1) dhe për 6 ditë nga shpallja (shih dosjen 2). Ndër 5 dosjet e vëzhguara, katër nga pesë vendimit janë arsyetuar brenda afateve ligjore”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 102, datë 27.11.2013 është dorëzuar më datë 02.12.2013 (5 ditë);

Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 59, datë 08.05.2015 është dorëzuar më datë 14.05.2015 (6 ditë);

Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 253, datë 15.05.2014 është dorëzuar më datë 16.05.2014 (1 ditë);

Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 246, datë 26.07.2016 është dorëzuar më datë 27.07.2016 (1 ditë);

Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 61, datë 21.03.2016 është dorëzuar më datë 25.03.2016 (4 ditë);

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 27.5.2022, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 24.5.2022, rezulton se:

Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 38, datë 20.03.2014 është dorëzuar më datë 24.03.2014 (4 ditë);

Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 6, datë 15.01.2014 është dorëzuar më datë 20.01.2014 (5 ditë);

Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 149, datë 26.12.2014 është dorëzuar më datë 29.12.2014 (3 ditë);

Dosja 9, që i përket vendimit me nr. 61, datë 11.05.2015 është dorëzuar më datë 15.05.2015 (4 ditë);

Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 95, datë 11.07.2016 është dorëzuar më datë 15.07.2016 (4 ditë);

Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 87, datë 24.06.2016 është dorëzuar më datë 28.06.2016 (4 ditë).

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se; për kategorinë “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak” (dosja nr. 3, dosja nr. 4, dosja nr. 5), koha mesatare e

²⁵ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëpërmjet shkresës nr. 895/2 prot., datë 12.04.2023, protokolluar pranë KLGJ me nr. 2357 prot., datë 12.04.2023.

arsyetimit të vendimit është 2 ditë. Për kategorinë “penale krime”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit për 10 dosjet (1, 2, 6, 7, 8, 9, 10, 11) është 4 ditë.

Në KPRP në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10/ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë. Duke qenë se koha mesatare e dorëzimit të vendimit të arsyetuar nga ana e gjyqtarit në rastin konkret, është 2 ditë për një kategori dhe 4 ditë për kategorinë tjetër, ajo është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, çka vlerësohet si shkallë e lartë kujdesi që gjyqtari ka treguar për arsyetimin në kohë të vendimeve.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “..Subjekti i rivlerësimit Ardit Mustafaj në përgjithësi ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Dy prej dosjeve të

vëzhguara kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjet 3 dhe 4), dy dosje kanë përfunduar me 2 seanca (shih dosjet 2 e 5) dhe një dosje me 3 seanca (shih dosjen 1). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 9 seanca të zhvilluara prej tij. 8 prej këtyre seancave kanë qenë produktive dhe vetëm 1 seancë ka qenë joproduktive (shih dosjen 5). Në këtë rast të vetëm, seanca ka dështuar për paraqitjen e aktit të përfaqësimit nga ana e mbrojtëses përfaqësuese të zgjedhur nga kërkuesi. Në tre rastet e gjykimeve penale, të zhvilluara në 2,2 e 3 seanca, ato janë shtyrë brenda distancës procedurale kohore 15 ditore, të parashikuar në nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale (shih dosjet 2, 5 e 1)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 8 prej tyre janë çështje me palë kundërshtare dhe i përkasin kategorive “penale krime” ndërsa 3 prej tyre është e kategorisë “kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak”. Lidhur me numrin e seancave gjyqësore, për 8 çështjet të cilat vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, rezulton si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit:

Dosja 1, çështja me nr. regjistri 126, datë regjistrimi 16.10.2013, nr. vendimi 102, datë vendimi 27.11.2013. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore** të dokumentuara nëpërmjet procesverbalit të seancës, të cilat kanë qenë produktive;

Dosja 2, çështja me nr. regjistri 92, datë regjistrimi 02.04.2015, nr. vendimi 59, datë vendimi 08.05.2015. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit:

Dosja 6, çështja me nr. regjistri 54, datë regjistrimi 28.01.2014, nr. vendimi 38, datë vendimi 20.03.2014. Janë zhvilluar gjithsej **5 seanca gjyqësore**, prej të cilave 2 seanca gjyqësore ka qenë joproduktive, për shkak të mosprezencës së anëtarëve të trupit gjykues.

Dosja 7, çështja me nr. regjistri 29/147, datë regjistrimi 19.11.2013, nr. vendimi 6, datë vendimi 15.01.2014. Janë zhvilluar gjithsej **5 seanca gjyqësore** nga të cilat 2 seanca kanë qenë jo produktive, për shkak të mosprezencës së prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit.

Dosja 8, çështja me nr. regjistri 78, datë regjistrimi 24.03.2014, nr. vendimi 149, datë vendimi 26.12.2014. Janë zhvilluar gjithsej **28 seanca gjyqësore** nga të cilat 11 kanë qenë jo produktive. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura të tilla si; 3 seanca për mungesë të mbrojtësve të të pandehurve, 5 seanca për mungesë të prokurorit dhe 3 seanca për mosformim të trupit gjykues.

Dosja 9, çështja me nr. 89 regjistri, datë regjistrimi 18.03.2015, nr. vendimi nr. 61, datë 11.05.2015. Janë zhvilluar gjithsej **5 seanca gjyqësore** nga të cilat 2 kanë qenë jo produktive për shkak të pushimit zyrtar të vendosur me VKM dhe mosprezencës së mbrojtësit të të pandehurit.

Dosja 10, çështja me nr. 20/55 regjistri, datë regjistrimi 29.07.2015, nr. vendimi 95, datë 11.07.2016. Janë zhvilluar gjithsej **33 seanca gjyqësore** nga të cilat 18 kanë qenë jo produktive. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura të tilla si; 6 seanca për mosformim të trupit gjykues, 9 seanca për shkak të mungesës së mbrojtësve të të pandehurve dhe 3 seanca me qëllim njoftimin e dëshmitarëve.

Dosja 11, çështja me nr. regjistri nr. 76/228 regjistri, datë regjistrimi 29.12.2015, nr. vendimi 87, datë 24.06.2016. Janë zhvilluar gjithsej **14 seanca gjyqësore**, nga të cilat 6 seanca kanë qenë jo produktive. Seancat është shtyrë për shkaqe procedurale të përligjura; 1 për shkak të mosformimit të trupit gjykues, 4 seanca për qëllim njoftimin e të pandehurit dhe 1 seancë për shkak të mungesës së mbrojtësit të të pandehurit.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 8 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli) varion nga 5 (dosja 6 dhe 7) deri në 33 seanca gjyqësore (dosja 10). Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 8 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 11 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 8 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje themeli me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural (neni 333 dhe 342/2 të K.Pr.P). Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë, pavarësisht numrit të lartë të të pandehurve dhe mbrojtësve respektive, për shkak të natyrës së çështjeve, që ka sjellë si pasojë zhvillimin e një numri të lartë seancash në disa raste.

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimi i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurve, njoftimi për të marrë pjesë i prokurorit, njoftimi të dëshmitarëve, etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P, përveçse kur kjo ka qenë objektivisht e pamundur.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 8 çështjeve²⁶ të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 11 seanca.

Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Shkaqet e shtyrjeve lidhen me kryerjen e veprimeve procedurale të domosdoshme sikundër njoftimi i të pandehurit, mbrojtësve, dëshmitarëve..etj apo kushte procedurale që lidhen me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit, formimin e trupit gjykues etj.

²⁶ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “*Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse*”.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara, nuk vjen për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit. Gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproductive.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “..Ai është i qartë për rolin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura nga palët në shkallën e parë të gjyqimit. Ndër 5 dosje të vëzhguara, në të gjitha rastet është pranuar kërkesa e organit të prokurorisë dhe së fundmi, në këtë aspekt duhet evidentuar se tre nga pesë vendimet e dosjeve të vëzhguara janë ankimuar, por janë lënë në fuqi nga shkalla e dytë e gjyqimit. Gjithashtu, nuk ka të dhëna negative nga shqyrtimi i ankesave të paraqitura ndaj tij (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore në çdo rast 0 deri 3 ditë pas caktimit të çështjes me short dhe në të njëjtën ditë me nxjerrjen e urdhrorit të Kryetarit për formimin e trupit gjykues, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Seancat gjyqësore për 8 dosjet që i përkasin çështjeve të themelit, janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.P. Në rastin e shqyrtimit të kërkesave së prokurorisë në lidhje me kërkesat penale të hetimit paraprak (dosja 3 dhe 5),

grykata ka marrë masa efektive për të mundësuar planifikimin dhe zhvillimin e seancave brenda afatit ligjor 48 orësh në rastin e vleftësimit të arrestit dhe brenda afatit 5 ditor në rastin e zëvendësimit të masës.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal sipas parashikimeve të nenit 335 e vijues të K.Pr.P dhe 405 e vijues ne rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për të relatuar regjistrimin e seancës në sistemin audio, relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjykimit në mungesë sipas parashikimeve të nenit 351 dhe 352 të K.Pr.P, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, dhe në rastet e çeljes me vonesë, ku pothuajse gjithmonë është shoqëruar me relatimin e shkakut që ka sjellë vonesën në çeljen e seancës, por nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Por konstatohet se jo në të gjitha dosjet gjyqësore, dokumentohet gjithmonë shkaku i vonesës së çeljes së seancave gjyqësore”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin kronologjik (sipas datës së aktit). Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur aktin e shortit, urdhrin e formimit të turpit gjykues, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, procesverbalet e seancave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike..”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezultojnë se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e administruara për herë të parë në seancë për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezultojnë se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke

zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së, konkluzionet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtarin Ardit Mustafaj është paraqitur vetëm 1 ankesë (në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së. Ankesa është paraqitur në vitin 2015, e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është mbajtur në vijim verifikimi deri në përfundim të gjyqimit në Gjykatën e Lartë. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Ardit Mustafaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore”.*

Referuar praktikës së tërhequr nga arkiva e ish KLD-së në lidhje me sa më sipër, rezulton se me relacionin e datës 23.10.2017 të Inspektoratit të KLD, është verifikuar dhe trajtuar ankesa e ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme me nr. 1313 prot, datë 14.04.2015, për mosrespektim formal të ligjit ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndër të cilët edhe gjyqtari Ardit Mustafaj, në lidhje me vendimin nr. 52, datë 03.04.2015. Me vendimin nr.52, datë 03.04.2015 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Dritan Hallunaj (kryesues), Ardit Mustafa, Fran Prendi, Liljana Baku dhe Klodian Kurushi (anëtarë), ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurit A.F, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 79/c në lidhje me nenin 25 dhe 278/2 të Kodit Penal duke hequr masën e sigurimit personal “Arrest në burg”. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda e vendimin nr. 73, datë 29.06.2015 ka vendosur ndryshimin e vendimit duke deklaruar fajtor të pandehurin A.F për veprat penale të parashikuara nga nenet 79 shkronja “c” dhe 178/2 të Kodit Penal duke e dënuar atë, në bashkim të dënimeve, me burgim të përjetshëm. Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2017-443, datë 08.06.2017 ka vendosur mospranimin e rekursit.

Konstatimi i shkeljes në drejtim të zgjidhjes në themel të çështjes, për shkak të qëndrimit të ndryshëm të mbajtur nga gjykata më e lartë në lidhje me vlerësimin e provave dhe fajësinë e të pandehurit, dhe referimi për t’u mbajtur në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, bazuar në Ligjin nr.96/2016 dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, nuk përbën një tregues për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit. Konkretisht në nenin 72, pika 4 të ligjit nr.96/2016, parashikohet se: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar

interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.”. Gjykimi mbi mënyrën e çmuarjes dhe vlerësimit të provave si dhe besueshmërinë e vendimit gjyqësor, përbëjnë gjykim mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, elementë të cilët nuk janë objekt i kontrollit për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit dhe, për këtë arsye, nuk mund të vlerësohen në kuadër të këtij procesi.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit 2013- 2016, gjatë së cilës ka filluar dhe përfunduar verifikimi nga Inspektorati i KLD-së për ankesën e parashtruar, nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës apo që mund të përdoren për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit.

Pra, për periudhën e vlerësimit Tetor 2013 - Tetor 2016, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës së gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, etika e gjyqtarit në lidhje me treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së, konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ardit Mustafaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara (me përjashtim të mangësive të evidentuara tek Aftësitë Organizative) konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Ardit Mustafaj, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për *gjyqtarin* Ardit Mustafaj është paraqitur vetëm 1 ankesë (në vitin 2015) në Inspektoratin e KLD-së. Ankesa është paraqitur në vitin 2015, e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është mbajtur në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Ardit Mustafaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore”.

Në relacionin e hartuar nga KLD, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

Nga vendimin nr. 34, datë 21.09.2022 të KPA-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se “...*Nga kryerja e analizës financiare për vitin 2004, mbi të dhënat e konsideruara sipas konkluzioneve më lart, rezulton se subjekti gjendet në kushtet e një balance negative prej 635.030 lekësh, për krijimin e pasurive dhe shpenzimeve të kryera në këtë vit. Këtë diferencë negative, e cila rezulton nga analiza financiare e këtij viti, Kolegji e vlerësoi në zbatim të parimeve të objektivitetit e proporcionalitetit, duke pasur parasysh së pari, faktin se ajo rezulton si konsekuencë e mosnjohjes në mënyrë të plotë të shumës së dhënë hua prej personit tjetër të lidhur, z. A. M., në kushtet specifike të rastit të cituara më lart, dhe jo si një produkt i raportit të të ardhurave e shpenzimeve të vetë subjektit të rivlerësimit. Së dyti, Kolegji vlerësoi gjithashtu si rrethanë të rëndësishme në përcaktimin e peshës së kësaj balance negative, deklaratimet e sakta e të plota të dhëna nga subjekti për këtë hua, dokumentimin e marrjes së saj dhe të shlyerjes nëpërmjet veprimeve noteriale që në kohën e hershme, si edhe shlyerjen e saj nëpërmjet një kredie të marrë për nevoja të strehimit. Verifikimi i vërtetësisë së deklaratimeve të subjektit, u konsiderua prej Kolegjit si një element që përforcoi besueshmërinë e ekzistencës së marrëdhënies së huas në termat e deklaruara prej subjektit, ndonëse jo të provuar në standardin e aplikuar prej Kolegjit, në zbatim të legjislacionit në fuqi, premisë e cila, konsideruar edhe faktin se mbetet e vetmja balancë negative në të gjithë periudhën e rivlerësimit, krijoi bindjen se subjekti e kapërcen testin e një niveli të besueshëm, për sa i përket vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.”*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, integriteti i gjyqtarit në lidhje me treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Ardit Mustafaj. Për vetë gjyqtarin Ardit Mustafaj në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit”.*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se; ”.. në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin nga gjykimi i çështjeve.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari*) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Nivelin i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për*

marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, etj.) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi :** Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.*

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e Inspektoratit të KLD-së konkludohet se *‘Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Ardit Mustafaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nga 9 seanca gjyqësore të vëzhguara, vetëm një seancë e caktuar nuk ka qenë produktive, për paraqitjen e aktit të përfaqësimit nga ana e mbrojtëses. Por konstatohet se përgjithësisht ka pasur vonesa në çeljen e seancave gjyqësore, që tregon edhe bashkëveprimin jo normal me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore (shih Aftësitë Organizative).*

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, vlerësohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social ...etj., duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, vlerësoj se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIK TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, dhe vërtetimeve nr. 795 prot., datë 21.10.2016 dhe nr. 59 prot., datë 19.01.2017, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës rezulton se gjyqtari ka qenë pjesëmarrës në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 17 aktivitete trajnuese për vitet 2013-2016 (gjithsej 32 ditë) si më poshtë:

- (i) “Njohja dhe garantimi i të drejtës së mbrojtjes me avokat në procesin penal”, ku ka qenë i pranishëm vetëm në ditën e parë dhe të dytë vetëm në sesionin II të trajnimit të zhvilluar në datë 20-21 mars 2014;
- (ii) “Instrumentet ligjore Evropiane për bashkëpunimin ndërkufitar në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit (bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale)”, trajnim i zhvilluar në datë 24-25 mars 2014;
- (iii) “Provat e marra në kundërshtim me ligjin, papërdorshmëria. Pavlefshmëria e akteve procedurale”, trajnim i zhvilluar në datë 20-21 maj 2014;
- (iv) “Veprat penale që lidhen me korrupsionin “, trajnim i zhvilluar ne datë 23-24 qershor 2014;
- (v) “Gjykimi në mungesë në procesin penal”, ku ka qenë i pranishëm vetëm ditën e parë (sesioni I) i trajnimit të zhvilluar në datë 4-5 maj 2015;
- (vi) “Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, trajnim i zhvilluar në datë 12-13 maj 2015;
- (vii) “Akuzat e reja. Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale, në gjykimin e zakonshëm dhe gjykimin e shkurtuar. Jurisprudenca e GJL-Së dhe GJEDNJ-së, trajnim i zhvilluar në datë 19-20 maj 2015;
- (viii) “Problematikat e gjykimit të drejtpërdrejtë. Gjykimet e posaçme dhe gjykimet e shkurtuara”, trajnim i zhvilluar në datë 23-24 qershor 2015;
- (ix) “Veprat penale “pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”. Hetimi financiar kriminal. Konfiskimi. Praktika gjyqësore dhe jurisprudenca e GJL, trajnim i zhvilluar në datë 6-7 korrik 2015;
- (x) “Konfiskimi i aseteve në kuadër të ligjit antimafia”, trajnim i zhvilluar në datë 2-3 nëntor 2015;
- (xi) “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Standardi i GJEDNJ për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit”, trajnimi i zhvilluar në datë 23-24 nëntor 2015;
- (xii) “Veprat penale në fushën e tatimeve”, trajnim i zhvilluar në datë 1-2 shkurt 2016”
- (xiii) “E drejta e konkurrencës”, trajnim i zhvilluar në datë 20 tetor 2016;
- (xiv) “Jurisprudenca e GJEDNJ lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Konventa e OKB dhe legjislacioni shqiptar lidhur me PAK dhe orli i sistemit të drejtësisë”, trajnim i zhvilluar në datë 31 tetor 2016;
- (xv) “Rastet praktike KEDNJ”, trajnim i zhvilluar në stë 9-10 nëntor 2016”;
- (xvi) “Refleksione rreth praktikës gjyqësore në lidhje me institutin e bashkëpunimit në veprën penale dhe problematikat e krijuara pas daljes së Vendimit Unifikues Nr. 4, datë 15.04.2011, të Kolegjeve të

Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Konsiderata në lidhje me këndvështrimet në lidhje me kufijtë e shtrirjes së përgjegjësisë penale individuale”, trajnim i zhvilluar në datë 14-15 dhjetor 2016”;

(xvii) “Neni 10 i KEDNJ mbi të drejtën e shprehjes dhe jurisprudenca e GJEDNJ. Legjislacioni dhe praktika shqiptare”, trajnim i zhvilluar ë datë 20-21 dhjetor 2016.

Pra, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjyqtari Ardit Mustafaj, është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në 17 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 32 ditë trajnimi.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 32 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtari, rezulton se ai nuk është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin Ardit Mustafaj, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë tregues.

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Ardit Mustafaj, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Në lidhje me këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtime lidhur me nivelin pikëzimit dhe ka paraqitur dokumenta shtesë të cilët provojnë pjesëmarrjen dhe angazhimin e tij në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë. Nga ana e relatores u propozua gjatë mbledhjes së Këshillit, që të merren në konsideratë të dhënat e reja në lidhje me këtë tregues, duke vlerësuar gjyqtarin me 5 pikë.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli duke marrë parasysh, propozimin e relatores për rritjen e nivelit të pikëzimit në lidhje me këtë tregues, duke qenë se rezultojnë të dhëna të reja nga provat bashkangjitur kundërshtimeve të paraqitura nga gjyqtari Ardit Mustafaj, si u diskutuan në mbledhjen plenare, arriti në përfundimin që gjyqtari të vlerësohet me pikëzim maksimal.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër në lidhje me treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se;

Gjyqtari Ardit Mustafaj, ka deklaruar dhe ka paraqitur dy dokumente ligjore (botime) që i përkasin periudhës së vlerësimit të cilat janë;

- Mustafaj Ardit 2015. “Tregtimi dhe trafikimi i paligjshëm i armëve dhe municioneve : Nevojat për përmirësim në legjislacionin penal”, Revista Shqiptare për Studime Ligjore Vol 8 (2015). 56-67. ISSN 2074-0360.
- Mustafaj Ardit. 2016. “Disa çështje të luftës kundër korrupsionit publik sipas sistemit dhe praktikës ligjore në Shqipëri”, Revista Ballkanike e Kërkimeve Ndërdisciplinore, Vol 2, No. 2- Shtator 2016. 280-285. ISSN 2410-759X.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se, për gjyqtarin Ardit Mustafaj ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë duhet të pikëzohet me 5 pikë.

***Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “publikime ligjore akademike” rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak do të pikëzohet me 5 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Nivelin i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	98	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	398	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR